



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
REKTORATI

Nr. 1990/2 Prot.

Vlorë më, 19.09.2024

**VENDIM**

Nr. 9, datë 19.09.2024

**PËR**

**KOMUNIKIMIN ME MEDIAN VIZIVE, MEDIA E SHKRUAR, MEDIA ELEKTRONIKE DHE SOCIALE PRANË ÇDO NJËSIE KRYESORE DHE REKTORATIN E UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 40, të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26 të Statutit të UV si dhe Vendimit të Rektoratit Nr. 7, datë 09.09.2024 "Për hapjen e faqeve/mediave sociale për llogari të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Rektorati i UV në mbledhjen e datës 19. 09.2024

**VENDOSI:**

1. Pranë çdo Njësie Kryesore në UV si dhe në Rektorat të këtë një përfaqësues përgjegjës për komunikimin me median vizive, media e shkruar, media elektronike dhe sociale.
2. Përfaqësuesi i mediave pranë çdo njësie kryesore ka për funksion të japi informacion për njësinë në të cilën është zgjedhur.
3. Përfaqësuesi i mediave në rektorat ka për funksion të japi informacion në emër të Universitetit përfshirë rektoratin, njësitë kryesore dhe njësitë bazë.
4. Rektori cakton personin përgjegjës për komunikimin në rektorat.
5. Drejtuesi i njësisë kryesore cakton personin përgjegjës për komunikimin për Njësinë Kryesore.
6. Përfaqësuesi për mediat ka për detyrë:
  - Menaxhimin e informacionit që do tu vendosi në dispozicion mediave.
  - Realizon marrjen ose dhënien e informacionit nga organet e shtypit apo mjetet e komunikimit masiv për veprimtarinë e njësisë kryesore respektive/ veprimtarinë e Universitetit;
  - Ndhmon në shkrimin e përgjigjeve për të gjitha mjetet e komunikimit masiv;
  - Në bashkëpunim me Sektorin e Komunikimit dhe Marrëdhëniet me Publikun, përgatit konferencat e shtypit, takime ose intervista me gazetarë të ndryshëm për Rektorin apo Stafin e deleguar nga Rektori për dhënien e intervistave apo deklaratave për shtyp;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
REKTORATI

- Bashkëpunon me organet e medias dhe të shtypit për të pasqyruar veprimtarinë e Rektorit dhe Universitetit, veprimtarinë e Njesisë Kryesore duke mbajtur përgjegjësi të drejtpërdrejtë për njoftimin e tyre për çdo eveniment, aktivitet, etj
- Përfaqësuesi për mediat në Rektorat mban lidhje dhe bashkëpunon me koordinorët e tjerë dhe zëdhënësit për shtyp të Njësive Kryesore, me qëllim realizimin e objektivave dhe misionit të përbashkët në funksion të informimit të mediave dhe stafit akademik, studentëve dhe të tretëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Aurela SALIAJ



*Ne kudoq ne hollim*